

VENDIM
Nr.542, datë 7.7.2010

PËR TRANSFERIMIN E SIPËRFAQES 116 M², NGA TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR.1047 “QENDËR MOBILIZIMI”, BERAT, NË PRONËSI TË BASHKISË BERAT DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja “c”, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e sipërfaqes 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) m² dhe gjatësi 38.6 (tridhjetë e tetë pikë gjashtë) ml, nga trualli funksional i pronës nr.1047 “Qendër mobilizimi” në Berat, e cila ndodhet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, në pronësi të bashkisë Berat, sipas genplanit bashkëlidhur, për ta përdorur për nevoja urbanistike (rrugë publike).

2. Në listën e pronave bashkëlidhur vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet sipërfaqja 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) m² nga trualli funksional i pronës nr.1047 “Qendër mobilizimi” në Berat.

3. Bashkisë Berat i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e sipërfaqes të përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Bashkia Berat të rindërtojë murin rrethues, që do të prishet, brenda një muaji nga dorëzimi i sipërfaqes së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të bëjë dorëzimin për kalimin në pronësi të kësaj sipërfaqeje bashkisë Berat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe bashkia Berat për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të nevojshme për transferimin e kësaj sipërfaqeje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE (Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Bashkia Berat										
A				B			C			
N r.	Zona kadastrale i hartës	Numri i pasurisë	Lloji i pronës	Emërtimi i pronës adresë	Sipërfaqe totale pronës në m²	Nga sipërfaqe totale ndërtime në m²	Funksioni për të cilin përdoret pronë	Enti me përgjegjësi administrative	Enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera shënim të veçantë
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1047				Qendra e mobilizimit	1468 m ²	468 m ²	ër	MM Qendra e mobilizimit	Qendra e mobilizimit Berat	

				Berat, lagjja “30 vjetori”			mbrojtj en	Berat		
				Godina e QM	268	268				3 kate
				Truprojë klasa	200	200				
				Truall	1000	-				

